



Drejt një Buxheti më të përgjegjshëm gjinor të Kosovës 2026

28 Gusht 2025

E nderuar Sekretare e Përgjithshme znj. Fadile Dyla,
I nderuar Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa z. Fehmi Zylfiu,

Po ju shkruaj në emër të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), për të kërkuar që të shqyrtohen me prioritet kërkesat buxhetore për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2026.

Siç mund të jeni të informuar, buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) synon të sigurojë që fondet të planifikohen dhe të shpenzohen për të adresuar nevojat e ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave të identifikuar përmes analizës gjinore. Sipas Ligjit të Kosovës [Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore](#), BPGJ është i detyrueshëm për të gjitha institucionet publike. Mospërmblidhja e këtij obligimi, siç përcaktohet nga ky Ligj, përbën një shkelje ligjore dhe është e dënueshme me sanksione. Për më tepër, Qeveria ka interes në zbatimin e buxhetimit gjinor në kuadër të [përkushtimeve të saj ndaj Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara \(OZHQ\)](#), konkretisht [OZHQ 5, treguesi 5.c.1; Korniza Suplementare e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësi Financiare për vlerësimin e menaxhimit](#) financiar publik të përgjegjshëm gjinor ([PEFA GRPFM](#)) dhe, më e rëndësishmja, si një praktikë e mirë në menaxhimin financiar. Zbatimi i BPGJ-së mund të kontribuojë në një shpenzim më efektiv, të përgjegjshëm dhe transparent të burimeve qeveritare, përfshirë edhe drejt arritjes së barazisë gjinore. Prandaj, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes [qarkores buxhetore](#), ka kërkuar që të gjitha organizatat buxhetore të përfshijnë një shtojcë në kërkesat e tyre për ndarjen buxhetore duke shpjeguar se si buxheti i tyre për vitin 2026 siguron BPGJ-në.

Qeveria të përfshijë zyrtarët për barazi gjinore nga entitetet qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile në konsultimet publike që lidhen me buxhetin, siç kërkohet nga [Rregulloria \(QRK\) Nr. 12/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore Në Ministri dhe Komuna](#) si dhe [Rregulloria \(QRK\) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës](#). Për të mbështetur Qeverinë në zbatimin e përgjegjësi të saj, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), një rrjet prej 102 organizatash të ndryshme për të drejtat e grave, ka përgatitur këtë letër me rekomandime për përmirësimin e BPGJ-së në lidhje me Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026.

Ne fuqimisht rekomandojmë që Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të investojë drejtpërdrejt dhe të inkurajojë komunat të planifikojnë buxhet më të përballueshëm për krijimin e më shumë qendrave publike dhe kopshteve për kujdesin e fëmijëve sidomos në [zonat rurale](#). Duke vendosur objektiva konkrete dhe [alokime buxhetore bazuar në vlerësime të gjithanshme të nevojave, komunat mund të adresojnë nivelet e larta të papunësisë dhe pasivitetit](#). RrGK ka vlerësuar se zgjerimi i opsioneve të kujdesit ndaj fëmijëve mund të krijojë [afërsisht 9,899 vende të reja pune në këtë fushë](#). Për më tepër, kjo do t'i mundësojë më shumë grave të punojnë dhe do të përmirësohen rezultatet arsimore në përputhje me [Objektivat e Barcelonës, BE](#).

Qeveria është zotuar për këto investime në [Strategjinë Kombëtare për Zhvillim](#) dhe tani duhet të bëhen alokimet buxhetore. Ndërsa Qeveria është mbështetur në donacionet ndërkombëtare për përmirësimin e disponueshmërisë së kujdesit për fëmijë, ne i bëjmë thirrje MASHTI-t të alokojë më shumë fonde të tilla dhe të inkurajojë fuqimisht komunat që të bëjnë të njëjtën gjë. Shpresojmë në uljen e mbështetjes në financime të jashtme për të siguruar burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme buxhetore për të ardhmen për këtë prioritet të rëndësishëm të zhvillimit kombëtar.

Ne inkurajojmë fuqishëm MASHT-in që të **përfshijë BPGJ-në në Strategjinë e Arsimit dhe Planet e Veprimit, në buxhetin vjetor të arsimit, si dhe në politikat dhe legjislacionin tjetër për edukimin e hershëm fëmijëror (EHF) dhe për asistencën sociale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së EHF-së dhe [promovimin e të nxënësve që sfidon stereotipet e dëmshme](#).** Ju lutemi të planifikoni buxhet për zbatimin e pedagogjisë dhe të sigurimit të cilësisë të përgjegjshme gjinore, duke përfshirë indikatorë për vlerësimin e zbatimit të kurrikulave, cilësisë së shërbimeve dhe përfituesve të shërbimeve për vajza dhe djem, duke përdorur metodologjinë e përcaktuar nga RrGK. Linjat buxhetore duhet të ndajnë fonde për strategjitë e sigurimit të cilësisë, skemat sociale, strategjitë e rekrutimit (**veçanërisht për burrat në**

EHF), aktivitetet e angazhimit të komunitetit dhe trajnime, duke përfshirë trajnimin e **detyrueshëm të mësimdhënësve për të siguruar që ata të mund të zbatojnë kurrikulat që u ofrojnë vajzave dhe djemve mundësi të barabarta të të nxënës.**

Investimi në arsim cilësor mund të sigurojë që ndarjet buxhetore të përkthehen në rezultate domethënëse për barazinë gjinore, në përputhje me [Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III, CEDAW, OZHQ-të](#) dhe Objektivat e Barcelonës të BE-së.

Ne gjithashtu rekomandojmë që MASHT-i të investojë drejtpërdrejt dhe të inkurajojë komunat që të **buxhetojnë për arritjen e qasjes universale në kompjuterë dhe internet** në të gjitha shkollat e Kosovës, veçanërisht në zonat rurale. Duhet të ndahen burime për të siguruar që **aftësitë digjitale të përgjegjshme gjinore** të integrohen në kurrikula, në mënyrë që si vajzat ashtu edhe djemtë të fitojnë kompetencat e nevojshme për pjesëmarrje në tregun e punës. [Evidencat tregojnë se, megjithëse gratë dhe burrat kanë qasje të ngjashme në telefona të mençur dhe internet, 41% e grave në zonat rurale \(krahasuar me 33% të burrave në zonat rurale\) u mungojnë aftësitë digjitale të kërkuara nga tregu i punës.](#) Investimi në qasje të barabartë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, si dhe në trajnime për aftësi digjitale, do t'u mundësojë grave dhe burrave në zonat rurale të përdorin mjetet digjitale për bujqësi, tregje dhe shërbime publike, duke mbështetur fuqizimin ekonomik të grave dhe duke zgjeruar mundësitë e tyre në tregun e punës.

Ne i bëjmë thirrje MASHT-it që të publikojë shtojcën e Buxhetit të vitit 2026 të Ministrisë suaj, të kërkuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe në përputhje me OZHQ 5, treguesi 5.c.1; duke shpjeguar në mënyrë transparente se si buxheti juaj për vitin 2026 do të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore dhe shpenzimet përkatëse të parashikuara.

Ju faleminderit për bashkpunimin tuaj të vazhdueshëm.

Sinqerisht,
Igballe Rogova
Drejtoresh Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës